



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Ministri**

2375  
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 30.04.2010

**URDHËR**

238  
Nr. \_\_\_\_\_, datë 30.04.2010

**PËR**

**LEJIMIN PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE NË PËRPUTHJE ME  
LICENSAT E DHËNA PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA, SHKOLLËS SË  
LARTË PRIVATE "PAVARËSIA"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr. 279 datë 12.09.2009 "Për dhënien e Lejes për Hapjen e Shkollës Private të Arsimit të Lartë "Pavarësia" dhe të propozimit të Komisionit të Veçantë, i ngritur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, nr. 80 datë 08.02.2010 "Për ngritjen e Komisionit të Vecantë për shqyrtimin e kërkesave së bashku me praktikat e plota për hapjen e institucioneve private të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë, ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve si dhe të lejeve për fillimin e veprimtarisë":

**URDHËROJ:**

1. Lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike të Shkollës së Lartë Private "Pavarësia", në përputhje me VKM nr. 279 datë 12.09.2009 "Për dhënien e Lejes për Hapjen e Shkollës Private të Arsimit të Lartë "Pavarësia", për programet e studimit si diplomë e nivelit të parë (DNP) në:
  - a. Drejtësi;
  - b. Ekonomi;
  - c. Shkenca Politike;
  - d. Inxhinieri Informatike.dhe Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) në Arkitekturë.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe Shkolla e Lartë Private “Pavarësia”.

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

  
**MYQEREM TAFAJ**  
**MINISTËR**

